

KONTRATE PER SHITBLERJE AKSIONESH

Lidhur më datë 20-21 Dhjetor, 2006



Midis

SANPAOLO IMI S.p.A., shoqëri e së drejtës italiane, me seli ligjore në Piazza San Carlo N. 156, Torino, Itali, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Torinos, Kod Fiskal dhe NIPT N. 06210280019, përfaqësuar nga z. Giuseppe Cuccurese i pajisur rregullisht me prokurë, datë [] për qëllimet e kësaj Marrëveshje, lëshuar nga z. Alfonso Iozzo, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Sanpaolo Imi S.p.A (këtu e më poshtë, "Blerësi")

-nga një anë-

dhe

FONDI SHOIPTARO-AMERIKAN I NDËRRMARJEVE, shoqëri jo fitimprurëse e themeluar dhe e regjistruar në Shtetin Delaware, e krijuar sipas ligjeve të Shtetit Delaware, SHBA, me seli ligjore nw adreswn: 14 East 60-th Street, Suite 407., New York, NY 10022 U.S.A., Kod Fiskal Nr. 13/3826249, përfaqësuar nga z. Michael Granoff, në cilësinë e Kryetarit të Bordit Drejtues të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërrmarrjeve, i autorizuar rregullisht për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, me vendim të Bordit Drejtues datë 18 Dhjetor, 2006 (këtu e më poshtë, "Shitësi")

-nga ana tjetër-

(Blerësi dhe Shitësi do quhen bashkarisht "Palët" dhe, secili, "Palë")

KUSHTET PARAPRAKE

- (A) Shitësi të zotërojë 100% (njëqind përqind) të gjithë kapitalit të derdhur të American Bank of Albania - Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A." (këtu e më poshtë "Banka"), shoqëri e së drejtës shqiptare, me seli qendrore në adresën: Rruga Ismail Qemali N.27, Tiranë, Shqipëri, kapitali i së cilës është USD 33, 400,000 (tridhjetëtre milion e katërqindmijë) i ndarë në 15,000,000 (pesëmbëdhjetmilion) aksione me vlerë nominale prej USD 2,2266 (dy pikë dymijë e dyqind e gjashtëdhjetegjashtë) për cdo aksion dhe është regjistruar në Regjistrin Tregtar me Nr. 19460, datë 19 Maj 1998.
- (B) Shitësi ka qëllim t'i shesë Blerësit, i cili do blejë nga Shitësi 12,000,000 (dymëdhjetmilion) aksione të Bankës, (baraz me 80%) të kuotës së pjesëmarrjes aksionare (tetëdhjetë përqind) të gjithë kapitalit të Bankës (këtu e më poshtë "Pjesëmarrja") sipas afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.



MEQË EKZISTOJNË kushtet paraprake, Palët bien dakord për kushtet dhe afatet e mëposhtme:

SEKSIONI I – KUSHTET PARAPRAKE; PERKUFIZIME; INTERPRETIMI

1.1.1 Kushtet paraprake dhe Shtojcat

Kushtet paraprake dhe Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e kësaj Marrëveshjeje.

1.1.2 Përkufizime

Për qëllimit e kësaj Marrëveshjeje, fjalët me shkronjë shtypi do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

- “SSHK” do të thotë Standardet Shqiptare të Kontabilitetit;
- “Parimet e Kontabilitetit” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 7.8;
- “Shuma e zbritshme” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 9.2.1 (ii);
- “Marrëveshje” do të thotë kjo marrëveshje për shitblerje aksionesh, përfshirë kushtet paraprake dhe Shtojcat, si dhe cdo ndryshim të marrëveshjes;
- “Plani i shpërblimit nw aksione për punojësit, me ndryshime” do të thotë Plan i shpërblimit nw aksione për Punojësit, sic përcaktohet dhe në fuqi që nga Data e Mbylljes, formulari i së cilës është bashkangjitur këtu si Shtojca 1.2.A;
- “Ekspert kontabwi ” do të thotë KPMG Shqipëri Sh.p.k.;
- “Autoriteti” do të thotë cdo institucion publik, përfshirë por pa u kufizuar, në autoritetet lokale apo qeveritare, gjykata, arbitra dhe agjenci publike apo cdo autoritet tjetër rregullator kompetent;
- “Autorizimet” do të thotë cdo autorizim, licensë, leje, përjashtim nga taksat, vërtetim, miratim, pëlqim lëshuar nga Autoriteti kompetent;
- “Bankë” ka kuptimin që përcaktohet në gjithë klauzolat (A);
- “Autorizimet bankare” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 7.6;
- “Ditë Pune” do të thotë cdo ditë pune përveç ditës së Shtunë, të Dielë, ditës festive kombëtare në Shqipëri, në Itali apo në New York, SHBA, si dhe cdo dite kur bankat në Tiranë, Shqipëri, Torino, Itali apo New York, SHBA autorizohen të mbyllen;
- “Tarifat” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 13.7.2;
- “Pretendim për dëmshpërblim” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 11.1;
- “Mbyllja” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 2.2;
- “Bilanci nw Datën e Mbylljes” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 3.3.2;
- “Data e Mbylljes ” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 2.2;

- “**Deklarata Mbyllëse**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 6.1;
- “**Vlera Neto e Kapitalit në Datën e Mbylljes**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 3.3.2;
- “**Detyrime**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 5.1.3;
- “**Eksperti Kontabwl Vendimarrës**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 3.3.4;
- “**Shuma e caktuar**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 3.2.2 (b);
- “**Pretendim i drejtpërdrejtë**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 11.1;
- “**Rregullimi i Cmimit nw rënie**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 3.3.5;
- “**Plani i shpërblimit nw aksione pwr Punojësit**” do të thotë Plani i Shpërblimit në Aksione për Punojësit, i Bankës Amerikane të Shqipërisë për vitin 2004, sipas të cilit 2,250,000 aksione të Bankës u caktuan për nënpunësit dhe punojësit e Bankës;
- “**Llogaritja e Vlerës Neto të Kapitalit**” do të thotë vlera neto e kapitalit të Bankës, që është llogaritur më datë 31 Dhjetor 2006, nw shumwn prej 43,000,000 (dyzetetremilion) USD, sic përcaktohet në Buxhetin e Bankës për vitin 2007 bashkangjitur si Shtojca 1.2.C;
- “**Euro**” ose “**E**” do të thotë monedha zyrtare e shteteve anëtare të Bashkimit European, që përdorin këtë monedhë, në përputhje me Traktatin për themelimin e Komunitetit European, ndryshuar me Traktatin për Bashkimin European;
- “**Data e hyrjes në fuqi**” do të thotë data, në të cilën Palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje;
- “**Deklaratat Financiare**” do të thotë deklaratat financiare të audituara të Bankës që nga data 30 Qershor 2006;
- “**Degët në Greqi**” do të thotë, dy degë të Bankës themeluar sipas ligjeve të Republikës së Greqisë, dhe që ndodhen përkatësisht në Athinë dhe në Selanik;
- “**Pala e dëmshpërblyer**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 11.1;
- “**Pala dëmshpërblyese**” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 11.1;
- “**Njohja e Shitësit**” në lidhje me deklaratat dhe garancitë e Shitësit do të thotë njohja e anëtarëve të Bordit Drejtues të Shitësit ose të Presidentit dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shitësit;
- “**Ligj**” do të thotë cdo ligj, statut, urdhëresë, rregull, rregullore, urdhër, vendim apo dekret, vendim arbitrazhi, traktat, rregullore, udhëzim i detyrueshëm për Palët dhe/ose Bankën;
- “**Barrë**” do të thotë çdo barrë, peng, usufukt, hipotekë, ngarkim, privilegj, pretendim apo të drejta të të tretëve, e drejta e zgjedhjes, detyrime apo hipotekë pa kushte, të meta në tituj të drejtash apo kufizime të cdo lloji, përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën për votë, transferim apo shpërndarjes së të ardhurave nga letrat me vlerë;
- “**LIBOR**” do të thotë, në lidhje me cdo periudhë interesi, përqindjet e interesit në depozita në atë monedhë e për periudhën që përcaktohet këtu, sic paraqitet në ekranin elektronik si “faqe 3750” në Shërbimin e Sistemit Elektronik të Paraqitjes së Përqindjeve (apo në ekran elektronik tjetër apo shërbim tjetër që

zëvendëson të parin për të paraqitur përqindjet e Liborit të Shoqatës Angleze të Bankierëve për depozitat në atë monedhë në tregun ndërbankar të Londrës) që në ora 11.00 paradite në Ditën e Dytë të Punës para se të fillojë periudha e këtij interesi;

- **“Humbje”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 9.1 (i);
- **“Njofftim pwr Pretendim”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 11.1;
- **“Licensat Operative”** do të thotë licenca që ka lëshuar Banka Qëndrore e Shqipërisë për Bankën, më datë 10 Korrik 1998, që autorizon Bankën të kryejë aktivitetet që përcaktohen në Nenin 26, paragrafi 3,4 dhe 5 i Ligjit Shqiptar Nr. 8365, datë 2 Korrik 1998;
- **“Anëtarët e Planit me të drejtë zgjedhje”** do të thotë të gjithë punojësit dhe nëpunësit e Bankës të cilët, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj, kanë të drejtën e zgjedhjes për të blerë 1,797,525 numër aksione sipas Planit me drejtë zgjedhje për Punojësit;
- **“Aktiviteti ditor”** do të thotë që Banka ushtron aktivitetin e zakonshëm të saj në përputhje me Ligjin e zbatueshëm, rregulloret e brendshme të Bankës si dhe në bazë të praktikave të saj të mëparshme;
- **“Pjesëmarrje”** ka kuptimin që përcaktohet në cdo klauzolë (B);
- **“Cmimi”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 3.1;
- **“Rregullimi i Cmimit”** do të thotë Rregullimi i cmimit në Rritje apo në Zbritje, sipas rastit;
- **“Blerësi”** do të thotë SANPAOLO IMI S.p.A.;
- **“Pasuri të Paluajtshme”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 7.10.1;
- **“Shitësi”** do të thotë FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDËRRMARRJEVE;
- **“Marrëveshja e Aksionerëve”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 6.1 (viii);
- **“Shuma e zbritshme”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 9.2.1 (i);
- **“Taksa”** do të thotë cdo dhe të gjitha taksat, tatimet, tarifatat, mbledhje taksash, llogaritje, pullë takse apo shuma të tjera që do paguhet pranë cdo organi tatimor apo agjenci federale, shtetërore, lokale apo të huaj përfshirë por pa u kufizuar në taksat (i) mbi të ardhurat, franchise, fitimet, të hyrat bruto, taksë minimale, taksë minimale alternative, taksë e pritshme, taksë ad valorem, tvsh, e shitjes, për përdorim, për shërbimet, për pasuri të paluajtshme apo personale, kapitalin e shoqërisë, licenca, taksë mbi rrogat, tatim në burim, taksë për paafësi në punë, për punësim, sigurimet shoqërore, shpërblimin e punojësve, kompensim për papunësi, vlerë e dobisë, pushim pune, aksizë, pullë, tatime mbi fitimet nga lojrat e fatit, tatim mbi transferim dhe fitime kapitali, (ii) taksë doganore, detyrime, tarifë doganore, komisione, hyrjet nga taksat, apo të tjera të ngjashme të cdo lloji, dhe (iii) interesa, gjoba dhe taksa shtesë që caktohen në lidhje me to;
- **“Rimbursim Taksash”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 7.11;
- **“Pretendim i Palëve të Treta”** ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 11.1;

- “Rregullim i cmimit në rritje” ka kuptimin që përcaktohet në Seksionin 3.3.5;
- “USD” do të thotë monedha zyrtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

1.1.3 Gjinia dhe Numri

Cdo referencë për gjininë në këtë Marrëveshje do përfshijë të gjitha gjinitë dhe vetëm fjalët në njëjës do përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, përveçse kur parashikohet ndryshe.

1.1.4 Titujt, etj

Ndarja e kësaj Marrëveshjeje në Seksione, nënseksione, klauzola e në të tjera nënseksione, si dhe titujt janë vetëm në funksion të referimit dhe nuk do dëmtojnë apo do përdoren për hartimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.1.5 Monedha

Të gjitha referencat për monedhën në këtë Marrëveshje, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe, janë për USD.

1.1.6 Vecueshmëria

Cdo Seksion, klauzolë apo nënseksion tjetër në këtë Marrëveshje, apo cdo dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje që është, apo shndërrëhet në e paligjshme, e pavlefshme apo e pazbatueshme do hiqet nga kjo Marrëveshje dhe është e pazbatueshme deri në kufijtë e paligjshmërisë, pavlefshmërisë apo pazbatueshmërisë së saj si dhe nuk do prekë apo çënojë dispozitat e tjera të Marrëveshjes në kufirin maksimal që parashikohen ligji i zbatueshëm. Palët do negociojnë me mirëbesim për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje, në bazë të përcaktimit si më lart për cdo term apo dispozitë tjetër kur kjo është e paligjshme, e pavlefshme apo e pazbatueshme, dhe të ruajnë sa më saktë e mundur qëllimin e vërtetë të Palëve sic parashikohet në këtë Marrëveshje.

1.1.7 Keginterpretimet

Gjuha e përdorur në këtë Marrëveshje, do interpretohet në të gjitha rastet, në tërësinë e saj dhe do t'i jepet kuptimi i saktë, pa supozuar se termat këtu, do interpretohen në favor të një Palë përkundrejt Palës tjetër, në bazë të rregullit që dokumenti do interpretohet në favor të Palës që e ka hartuar atë, për arsye se përfaqësuesit e Palëve kanë pranuar se morën pjesë në hartimin dhe negocimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.8. Lista e Shtojcave

Sa më poshtë, janë Shtojcat që i bashkangjiten dhe janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje, dhe që identifikohen me numër Seksioni apo nënseksioni, sic tregohet në fillim:

- Shtojca 1.2.A- Plani i shpërblimit në aksione për punojësit, me ndryshime
- Shtojca 1.2 B - Plani i shpërblimit në aksione për punojësit”

- Shtojca 1.2.C –Buxheti i Bankës për vitin 2007;
- Shtojca 6.1 (viii) – Marrëveshja e Aksionerëve;
- Shtojca 6.1 (ix) – Deklarata Mbyllëse;
- Shtojca 7.8 –Deklaratat Financiare;
- Shtojca 7.9.1 – Punojësit (Shqipëri);
- Shtojca 7.9.3 –Punojësit (Greqi);
- Shtojca 7.10.1 – Pasuritë e paluajtshme;
- Shtojca 7.15 – Cështjet gjyqësore;

SEKSIONI II – OBJEKTI I KONTRATËS

2.1 Blerja dhe Shitja e Pjesëmarrjeve

Blerësi do blejë nga Shitësi dhe Shitësi do t'i shesë Blerësit, sipas afateve dhe kushteve që përcaktohen në kwtw Marrëveshjeje, në Datën e Mbylljes, Pjesëmarrjen.

2.2 Mbyllja

Përfundimi i transaksioneve që parashikohen në këtë Marrëveshje (këtu e më poshtë "Mbyllja") do kryhet në Bankë, ora 11.00 paradite (ora lokale) apo në një veftë ose orë tjetër sic do përcaktohet nga Palët me shkrim, dhe të gjitha kushtet që përcaktohen në Seksionin 4.1.1 duhet të jenë të plotësuara në Ditën e fundit të Punës, së muajit (këtu e më poshtë, "Data e mbylljes") nëse kushtet plotësohen brenda ditës së 15 të Muajit sic përmendet më lart. Nëse data kur përmbushen kushtet, sic përcaktohet në Seksionin 4.1.1, përkon me një datë pas ditës së 15 të muajit, Data e Mbylljes së Transaksionit do caktohet Dita e fundit e Punës e muajit pasardhës kalendarik. Data e Mbylljes së Transaksionit mund të jetë një datë tjetër, për të cilën Palët bien dakord me shkrim. Lidhur me sa më lart, Palët bien dakord që Blerësi ka të drejtë të propozojë një ditë të vecantë, për Datën e Mbylljes së transaksionit, me njoftim me shkrim që duhet t'ia komunikojë Shitësit së paku 10 (dhjetë) Ditë Pune para datës që ky propozon. Në rast se Shitësi nuk përgjigjet me shkrim së paku 5 (pesë) ditë para datës që i propozohet, kjo e fundit do quhet e miratuar nga Shitësi.

SEKSIONI III-CMIMI I BLERJES

3.1 Cmimi

Në lidhje me shitjen dhe transferimin e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi, ky i fundit bie dakord t'i paguajë Shitësit, sipas dispozitave që përcaktohen në Seksionin 3.2 më poshtë shumën prej 125.520.000 USD (njëqindnjëzetepesë milion e pesëqindnjëzetë mijë) (këtu e më poshtë, "Cmimi").

3.2 Pagesa

3.2.1 Më ose para datës 1 Janar 2007, Blerësi do depozitojë Cmimin në llogarinë rrjedhëse të Bankës, me përqindje interesi vjetor baraz me 120-ditë LIBOR minus 0,25%.

3.2.2 Në ditën e Mbylljes së Transaksionit, Banka me kërkesë me shkrim të Blerësit do paguajë Cmimin për llogari të tij, pa taksën e tatimit në burim apo kompensimin, sipas afateve dhe kushteve si më poshtë vijonë:

(a) shumën prej 110,002,662.92 USD (njëqinddhjetëmilion dymijë e gjashtëqindgjashtëdhjetëedy pikë nëntëdhjetëedy), plus interesin e maturuar të saj, që nga data 1 Janar 2007, gjatë periudhës të Datës së Mbylljes së Transaksionit, në përqindjet, sic përcaktohet në Seksionin 3.2.1 dhe që do t'i paguhet Shitësit me transfertë bankare në fonde që ai disponon dhe në llogarinë bankare që ky i komunikon Bankës së paku 3 (tre) Ditë Pune para datës së Mbylljes së Transaksionit;

(b) shumën prej 15,517,337.08 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqindeshtatëmbëdhjetëmijë e treqindetridhjetëeshtatë pikë zerotë) plus interesin e maturuar të saj, që nga data 1 Janar 2007, gjatë periudhës të Datës së Mbylljes së Transaksionit, në përqindjet që përcaktohet në Seksionin 3.2.1 ("Shuma e Caktuar"), në formën e llogarisë garanci sic përcaktohet në Seksionin 3.2.1, në favor të Buxhetit me të drejtë Zgjedhjeje për anëtarët si dhe të Shitësit. Shuma e Përcaktuar, përfshin pagesën e plotë, të saktë dhe në kohë të cdo shume të detyrueshme për t'u paguar sipas Buxhetit me të drejtë zgjedhjeje për anëtarët apo Shitësin, sipas rastit, e në përputhje me Seksionin 3.2.3 dhe 3.2.4 si më poshtë;

3.2.3 Blerësi angazhohet plotësisht dhe pa kushte që të kryejë pagesën e plotë, të saktë dhe në kohë të Buxhetit me të drejtë zgjedhjeje për anëtarët, për cdo shumë që ai ka si detyrim përkundrejt tyre në përputhje me afatet dhe kushtet e Buxhetit me të drejtë zgjedhjeje të anëtarëve, me ndryshime.

3.2.4 Kur, në cdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Buxhetit me të drejtë zgjedhjeje të Anëtarëve, me ndryshime, e drejta për pagesë që i takon një Anëtar të Buxhetit me të drejtë zgjedhjeje, humbet apo hiqet, tërësisht apo pjesërisht, Blerësi merr përsipër, tërësisht apo pjesërisht, t'i paguajë të njëjtën shumë në mënyrë të plotë, të saktë dhe në kohë Shitësit, e që Anëtar i Buxhetit me të drejtë zgjedhjeje nuk ka më të drejtë të përfitojë sipas Buxhetit me të drejtë zgjedhjeje për Punojësit, me ndryshime.

3.3 Rregullimi i Cmimit

3.3.1 Cmimi do jetë subjekt ndryshimi dhe si i tillë do rritet apo do ulet në bazë të Rregullimit të Cmimit që llogaritet në përputhje me procedurat që përcaktohen këtu më poshtë.

3.3.2 Blerësi, do urdhërojë Bankën që të përgatisë dhe t'i dorëzojë Shitësit dhe vetë Blerësit, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë Pune pas Datës së Mbylljes së Transaksionit, bilancin e Bankës që nga Data e Mbylljes ("Bilanci në Datën e Mbylljes") të kontrolluar nga Eksperti, ku tregohet vlera neto e kapitalit të Bankës po nga kjo datë ("Vlera neto e kapitalit në datën e mbylljes") e që përcaktohet në bazë të Parimeve të Kontabilitetit e në përputhshmëri me Deklaratat Financiare.

3.3.3 Shitësi do rishikojë Bilancin në Datën e Mbylljes që dorëzon Banka, sipas Seksionit 3.3.2 më lart, me ndihmën e këshilltarëve të tij si dhe në bashkëpunim me Bankën dhe Ekspertin, brenda 45 (dyzetepesë) Ditë Pune nga marrja në dorëzim të kësaj. Në rast se Shitësi do miratojë saktësinë e Bilancit në Datën e Mbylljes, Vlera Neto e Kapitalit, që përcaktohet në të, do jetë detyrues dhe i pandryshueshëm.

3.3.4 Megjithatë, në rast se Shitësi nuk bie dakord me saktësinë e Bilancit në Datën e Mbylljes që i ka dorëzuar Banka sipas Seksionit 3.3.2 më lart, çështja do parashtrohet menjëherë para një firme auditimi ndërkombëtare, e ndryshme nga Eksperti Kontabël dhe nga këshilltarët financiarë të Shitësit, dhe do vendoset me marrëveshje nga Palët, në rast të kundërt, do caktohet nga [.] ("Eksperti Kontabël Vendimmarrës"). Eksperti Kontabël Vendimmarrës, brenda 30 ditëve, do rishikojë bilancin dhe do t'i dorëzojë Shitësit.

3.3.5 Në rast se Vlera Neto e Mbylljes e përcaktuar në bazë të Seksionit 3.3 është:

- (i) më e ulët se Vlera Neto e Llogaritur, një shumë e barabartë me 80% të diferencës midis Vlerës Neto të Llogaritur dhe Vlerës Neto të Mbylljes, plus interesat e maturuara që prej Datës së Mbylljes deri në datën e pagesës me këste vjetore të barabartë me 60-ditë LIBOR minus 0.25% ("Rregullimi i Cmimit në Ulje"), duhet t'i rimbursohen Blerësit nga Shitësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune nga data e këtij përcaktimi në llogarinë bankare që përcaktohet nga Blerësi jo më vonë se 5 (pesë) Ditë Pune pas këtij përcaktimit; ose

- (ii) më e lartë se Vlera Neto e Llogaritur, një shumë e barabartë me 80% të diferencës midis Vlerës Neto të Llogaritur dhe Vlerës Neto të Mbylljes, plus interesat e maturuara që prej Datës së Mbylljes deri në datën e pagesës me këste vjetore të barabartë me 60-ditë LIBOR minus 0.25% (“Rregullimi i Cmimit në Rritje”), duhet t’i paguhet Blerësit nga Shitësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune nga data e këtij përcaktimi në llogarinë bankare të Blerësit që komunikohet nga ky, jo më vonë se 5 (pesë) Ditë Pune pas datës së përcaktimit si më lart.

SEKSIONI IV – KUSHTET

4.1 Kushtet e transferimit të Pjesëmarrjes.

4.1.1 Detyrimet e Shitësit për t’i shitur Pjesëmarrjen Blerësit dhe të Blerësit për të blerë Pjesëmarrjen nga Shitësi, sipas afateve dhe kushteve që përcaktohen në këtë Kontratë, duhet të plotësojnë, në ose para Datës së Mbylljes, të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (i) Banka e Shqipërisë të miratojë blerjen e Pjesëmarrjes nga Blerësi, sipas kësaj Kontrate;
- (ii) Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës të miratojë përqëndrimin e ndërmarrjeve që rezultojnë si pasojë e blerjes së Pjesëmarrjes nga Blerësi sipas kësaj Kontrate;
- (iii) Autoriteti Bankar Italian të miratojë blerjen e Pjesëmarrjes nga Blerësi sipas kësaj Kontrate.

4.1.2 Nëse kushtet e parashikuara nga Seksioni IV nuk janë përmbushur brenda 140 (njëqind e dyzet) ditëve nga Data e Ekzekutimit, çdo palë ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër, pa detyrime kundrejt njëra tjetrës, përveç rastit të shkeljesë së kësaj Kontrate. Në rast se Kontrata zgjidhet sic përcaktohet në Seksionin 4.1.2.,

Palët janë në dijëni se Cmimi që do derdhet nga Blerësi në llogarinë garanci sic përcaktohet në Seksionin 3.2.1, plus interesat e maturuara të saj, do t'i disbursohet menjëherë Blerësit nga Banka.

4.1.3 Dhe detyrimi i Blerësit për të blerë Pjesëmarrjen, sipas afateve dhe kushteve që përcaktohen në këtë Kontratë, duhet të përmbushë, ose Blerësi duhet të heqë dorë me shkrim, në ose para Datës së Mbylljes, nga kushtet si më poshtë vijojnë:

- a) Mungesa e vendimit të Autoriteteve për të refuzuar, hequr apo për të pezulluar licensën bankare që i është lëshuar Bankës apo të Autorizimeve Bankare;
- b) mungesa e një vendimi të Gjykatës kompetente që deklaron falimentimin apo likuidimin e Bankës;
- c) mungesa e procedurave të likuidimit në lidhje me Bankën;
- d) mungesa e vendimit të Gjykatës dhe/ose masës provizore që vendos Gjykata për të ndaluar aktivitetin normal të Bankës.

SEKSIONI V- DETYRIMET E PALEVE

A. DETYRIMET E BLERËSIT

5.1 Veprimet për Përmbushjen e Kushteve të Mbylljes

5.1.1 Për sa parashikohet nga Ligji i zbatueshëm, Blerësi do kryejë të gjitha aktet në kompetencë të tij, sa e nevojshme për të përmbushur kushtet që përcaktohen në Seksionin 4.1.1 si më lart.

5.1.2 Përveç sa më sipër, Blerësi do depozitojë brenda 15 ditëve nga Data e Ekzekutimit, pranë cdo Organi Kompetent cdo kërkesë për Autorizimin ose njoftimin e duhur në mënyrë që të kryejë transaksionet që parashikohen në këtë Marrëveshje. Blerësi merr përsipër t'i sigurojë cdo Autoriteti të tillë, cdo dhe të gjithë informacionin e kërkuar dhe/ose dokumentacionin përkatës.

5.1.3 Nëse bëhet e qartë në mënyrë të arsyeshme se Autoriteti do miratojë vetëm një vendim që lejon plotësimin ose përmbushjen e kushteve që përcaktohen në Seksionin 4.1.1 subjekt i kushteve, detyrimeve, angazhimeve dhe/ose ndryshimeve (secila "Detyrim") Shitësi dhe

i zbatueshëm, Pala që duhet të plotësojë këto kërkesa duhet që, para se të kryejë këtë njoftim apo njoftimin për shtyp, të këshillohet menjëherë me Palën tjetër lidhur me kërkesat përkatëse për dhënien e këtij informacioni si dhe të marrë parasysh kërkesat e arsyeshme të Palës tjetër përsa i përket kohës, përmbajtjes dhe mënyrës së këtij njoftimi apo njoftimi për shtyp.

SEKSIONI VI-MBYLLJA

6.1 Mbyllja

Për të përmbushur në kohë kushtet që përcaktohen në Seksionin IV si më lart, në Datën e Mbylljes, do kryhen aktet e mëposhtme:

- (i) Palët do t'i sigurojnë njëri -tjetrit dokumentacionin që përmbush kushtet që përcaktohen në Seksionin IV më lart;
- (ii) Shitësi do mundësojë që anëtarët e Bordit Drejtues, Komitetit të Kredisë dhe Komitetit të Ekspertëve Kontabël të heqin dorë nga detyra e tyre në Datën e Mbylljes dhe të nënshkruajnë një deklaratë ku ato pranojnë se nuk kanë asnjë pretendim përkundrejt Bankës dhe se marrin përsipër të mos kryejnë asnjë veprim përkundrejt Bankës dhe/ose Blerësit;
- (iii) Shitësi do mundësojë që Banka të thërrasë mbledhjen e aksionerëve, ku do caktohen anëtarët e rinj e Bordit Drejtues dhe Komitetit të Kontrollit të Bankës, sic do vendoset nga Palët në përputhje me Marrëveshjen e Aksionerëve, dhe kuptohet që cdo anëtar duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e zgjedhshmërisë që parashikon Ligji i zbatueshëm;
- (iv) Buxheti për Shpërblimin e Punojësve me ndryshime, do hyjë në fuqi;
- (v) Blerësi do t'i paguajë Cmimin Shiësit, sic përcaktohet në Seksionin 3.2;
- (vi) Shitësi do t'i transferojë Blerësit Pjesëmarrjen. Akti i transferimit hyn në fuqi me regjistrimin e aksionerëve në librin e llogarive që mbahet nga Banka për këtë qëllim, sipas ligjit Shqiptar;
- (vii) Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit certifikatat që përfaqësojnë aksionet e Bankës, të cilat duhet të jenë lëshuar dhe përgatitur para Datës së Mbylljes, dhe të jenë fimosur rregullisht në emër të Blerësit në përputhje me Ligjin Shqiptar;
- (viii) Palët do zbatojnë marrëveshjen e aksionerëve sipas formës bashkangjitur këtu si **Shtojca 6.1. (viii)** ("Marrëveshja e Aksionerëve"); dhe
- (ix) Palët do hartojnë një deklaratë ku deklarojnë se kanë përmbushur kushtet që përcaktohen në Seksionin IV si dhe aktet që përcaktohen në Seksionin 6.1 (i) deri (viii) sipas formës bashkangjitur këtu si **Shtojca 6.1 (ix)** ("Deklarata Mbyllëse").

Palët bien dakord që të gjitha aktet që do kryhen në Datën e Mbylljes do quhen transaksion i vecantë në mënyrë që, sipas zgjedhjes së Palës në favor të së cilës do kryhet veprimi, Data e Mbylljes të mos quhet e mirëqenë përveç dhe kur të kryhet ky veprim. Palët njohin se kjo është dispozitë thelbësore e kësaj kontrate.

6.2. Garanci të tjera

Nëse, në çdo kohë pas Datës së Mbylljes, Blerësi quan të arsyeshme që cdo kalim i të drejtave, tjetërsim, transferim, regjistrim apo garanci të tjera janë të nevojshme apo të duhura për t'i transferuar Blerësit cdo të drejtë, titull apo interes të Shitësit, të regjistruar apo ndryshe, që ka në dhe për Pjesëmarrjen, Shitësi do kryejë dhe dorëzojë menjëherë, ose mundëson që të kryhet dhe të dorëzohen cdo dhe të gjitha aktet lidhur me kalimin e të drejtave, tjetërsimin regjistrimin dhe transferimin si dhe do ndër marrë apo do mundësojë kryerjen e gjithë veprimeve e të gjithë akteve, që Blerësi në mënyrë të arsyeshme i kërkon Shitësit për t'i transferuar Blerësit cdo të drejtë, titull apo interes të Shitësit, të regjistruar apo ndryshe, në dhe për Pjesëmarrjen që shitet nga ky Shitës në përputhje me këtë Marrëveshje.

SEKSIONI VII - DEKLARATA DHE GARANCI TË SHITËSIT

Shitësi do t'i sigurojë vetëm Blerësit, për vetë Shitësin dhe Pjesëmarrjen e tij, lidhur me Bankën, deklaratat dhe garancitë që përcaktohen në Seksionin VII.

Blerësi njih dhe pranon se Shitësi nuk do lëshojë asnjë deklaratë apo garanci tjetër, të shprehur apo të nënkuptuar, në asnjë Seksion ose klauzolë të kësaj Marrëveshjeje ose tjetër si dhe deklaratat e garancitë që do lëshohen për Blerësin si këtu më poshtë do zëvendësojnë dhe përjashtojnë cdo deklaratë dhe garanci apo peng tjetër të cdo lloji që parashikohen nga Ligji i zbatueshëm. Deklaratat dhe Garancitë e Shitësit, si këtu më poshtë, do jenë të vërteta dhe të sakta në Datën e Ekzekutimit dhe në Datën e Mbylljes.

A. CESHTJE LIDHUR ME SHITËSIN

Shitësi lëshon për Blerësin këto deklarata dhe garanci:

7.1 Tituj Aksionesh

Është pronari i ligjshëm dhe përfitues i aksioneve që shiten, sic tregohet më poshtë. Aksionet që njihsohen me Pjesëmarrjen janë të lira dhe pa Barrë, përvec 1,797,425 aksioneve (që përfaqësojnë 11,98% të aksioneve mbetëse të Bankës), që janë lëshuar për Buxhetin me të drejtë zgjedhje për Anëtarët sipas Buxhetit për Shpërblimin e Punojësve në Aksionë.

7.2 Kompetencat

Shitësi ka kompetencat dhe autoritetin e duhur që të zbatojë dhe të përmbushë këtë Marrëveshje si dhe detyrimet e saj si më poshtë vijojnë. Ekzekutimi dhe

Blerësi do vlerësojnë në mirëbesim nëse do ta quajnë Marrëveshjen të zgjidhur ose, në rast të kundërt, do përmbushin Angazhimet që kërkon Autoriteti kompetent. Në rastin e fundit, Shitësi dhe Blerësi do përpiqen maksimalisht, sipas përgjegjësiwe përkatëse që të jenë në përputhje me këtë Angazhim.

B. DETYRIMET E SHITËSIT

5.2 Bashkëpunimi me Shitësin

Shitësi do bashkëpunojë dhe do mundësojë që Banka të bashkëpunojë me Blerësin, ose të veprojë në mënyrë të drejtpërdrejtë kur kërkohet nga Ligji i zbatueshëm, për përgatitjen e praktikës së depozitimit (ve) sic përcaktohet në Seksionin 4.1.1 më lart dhe do bëjë të mundur që Banka t'i sigurojë Blerësit të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm në lidhje to, subjekt, sidoqoftë, i detyrimit të konfidencialitetit të Shitësit ose të Bankës.

5.3 Veprimet e Bankës në periudhën midis Datës së Ekzekutimit dhe Datës së Mbylljes

Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje ose në shtojcat e kësaj apo Blerësi jep pëlqimin e tij ndryshe me shkrim (kuptohet që (i) ky pëlqim nuk do refuzohet pa shkak nga Blerësi; dhe (ii) në rast se Blerësi nuk i kthen përgjigje kërkesës për miratim brenda 5 (pesë) ditë pune, kjo do quhet e mirëqenë), që prej datës këtu deri në Datën e Mbylljes, Shitësi do mundësojë që Banka:

- (i) të kryejë Aktivitetin e saj të Zakonshëm Ditor
- (ii) të mos (a) ndryshojë -aktin e themelimit ose statutin e Bankës, (b) të deklarojë apo të paguajë cdo dividend ose të shpërndajë para o asete, ose (c) të riblejë, paguajë apo përndryshe të blejë aksione nga kapitali aksionar i Bankës;
- (iii) të mos lëshojë apo të bie dakord të lëshojë aksione shtesë për, apo prime, garanci apo cdo të drejtë për të blerë aksione të cdo klase nga kapitali aksionar apo borxhe ose tituj pronësie të kthyeshëm apo të këmbyeshëm për këtë kapital aksionar;
- (iv) të mos punësojë punojës të rinj apo të ndryshojë të drejtat dhe detyrimet e punojësve të Bankës, në mospërputhje me praktikën e mëparshme, përveç se kur autorizohet ndryshe nga Ligji i zbatueshëm apo nga vetë individët ose nga kontrata kolektive, e me kuptimin që të shmagen paqartësitë, Banka duhet të punësojë deri në 5(pesë) punojës të rinj;
- (v) të mos rrisë rrogën apo kompensimin në para për punojësit në mospërputhje me praktikën e mëparshme, përveç rastit kur

Banka dhe punojësi kanë rënë dakord për këtë para Datës së Ekzekutimit apo kur autorizohet nga Ligji i Zbatueshëm apo nga vetë individi ose kontrata kolektive.

(vi) të mos kryejë shpenzime të mëdha që kalojnë shumën prej Euro 100,000, dhe të mos lidhë kontrata apo të marrë përsipër sipërmarrje detyruese me të tilla shpenzime, vetëm në rastin e investimeve që janë përfshirë në buxhet sic përcaktohet në Shtojcën 1.2.C ose në rast kur këto kërkohen për zhvillimin normal të aktivitetit të Bankës;

(vii) të mos lidhë kontrata parësore apo kontrata të zakonshme të Aktivitetit të Bankës apo me një vlerë që kalojnë shumën prej 100,000 Euro për transaksion dhe/ose 200,000 Euro në total;

(viii) të mos shesë, transferojë, hipotekojë, japë më qera ose të vendosë në dispozicion asetet apo pasuritë në pronësi të Bankës përveçse për qëllimet e zhvillimit të aktivitetit normal të Bankës;

ix) të mos ndryshojë metodat, parimet ose praktikat e kontabilitetit përveçse kur kërkohet ndryshe nga Ligji.

C. DETYRIMET E PALËVE.

5.4 Konfidencialiteti, Njoftimet Publike

5.4.1 Palët marrin përsipër (i) të ruajnë konfidencialitetin për afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe (ii) të mos japë asnjë informacion në lidhje me sa më lart palëve të treta pa miratim paraprak me shkrim të Palës tjetër, përveçse sa parashikohet nga Ligji i zbatueshëm apo nga Organi Kompetent, me kusht që secila nga Palët mund të bëjë publike shitjen dhe blerjen (sipas rastit) e (interetit të saj) Bankës, si këtu më poshtë.

5.4.2 Në rast se përhapja e informacionit apo e dokumenteve sic përshkruhet në Seksionin 5.1 më lart, parashikohet nga Ligji i zbatueshëm apo nga Autoriteti Kompetent, Pala së cilës i paraqitet kërkesë për të dhënë informacion, para se të kryejë këtë, do konsultohet menjëherë me Palën tjetër lidhur me kërkesat përkatëse për dhënien e informacionit dhe do marrë parasysh kërkesat e arsyeshme të Palës tjetër në lidhje me kohën, përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së informacionit. Në cdo rast, Pala që merr kërkesën për të dhënë informacion do japë vetëm informacionin që i kërkohet të bëjë të ditur dhe do përpiqet, në kufirin më të mundshëm që të ruajnë konfidencialitetin e këtij informacioni.

5.5 Njoftimi për Shtyp

Nuk do kryhet asnjë njoftim publik apo për shtyp në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, transaksionet që parashikohen këtu apo Mbylljen e transaksionit nga Palët përveç rastit kur Palët kanë rënë dakord më parë me shkrim për njoftimin përkatës dhe njoftimin për shtyp apo kur kjo kërkohet nga Ligji i zbatueshëm. Kur njoftimi publik apo për shtyp kërkohet nga Ligji

përbushja e kësaj Marrëveshjeje nga Shitësi si dhe e detyrimeve të saj si më poshtë, autorizohen rregullisht si gjithë veprimet e tjera të nevojshme për shoqërinë.

B. ÇËSHTJE LIDHUR ME BANKËN DHE AKTIVITETIN BANKAR

Shitësi deklaron dhe i garanton Blerësit se:

7.3 Organizimi dhe Kualifikimi

- (a) Banka është një shoqëri e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas ligjit Shqiptar, dhe ka kompetencat dhe autoritetin e duhur që të zotërojë, japë me qera si dhe të administrojë pasuritë e saj si dhe të kryejë aktivitetin e saj ashtu siç kryhet tani. Banka nuk është subjekt i asnjë deklarate lidhur me mosshlyerje detyrimesh, procedurë falimentimi apo tjetër procedurë të ngjashme.
- (b) Degët në Greqi janë themeluar dhe organizuar rregullisht sipas Ligjeve të Republikës së Greqisë, dhe kanë kompetencat e autoritetin e duhur që të zotërojnë, japin me qera si dhe të administrojnë pasuritë e tyre si dhe të kryejnë aktivitetin e tyre ashtu siç kryhet tani. Nuk ka snjë deklaratë për Degët Greke për mosshlyerje detyrimesh apo për procedure falimentimi apo për procedura të tjera të ngjashme.

7.4 Statuti dhe Akte të tjera

Banka është në përputhje me të gjitha dispozitat e Statutit të saj. Në librat e procesverbaleve të Bankës që janë në përputhje me kërkesat e ligjit, janë regjistruar në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjitha vendimet që janë marrë në mbledhjet e Bordit Drejtues, të Komitetit të Kontrollit si dhe të aksionerëve të Bankës. Në librin e llogarisë të aksionerëve të Bankës janë regjistruar në mënyrë të plotë dhe të saktë emetimi fillestar dhe transferimi i mëvonshëm i kapitalit aksionar të Bankës.

7.5 Kapitali i investuar

Më 31 Tetor 2006, kapitali aksioner i Bankës rezultonte i barabartë me 33,400,000 USD (tri dhjetë e tre milionë e katër qind mijë). Nuk ka rritje të kapitalit, emetim aksionesh ose operacione të tjera lidhur me kapitalin e Bankës, pezull ose për të cilat është lëshuar autorizim. Përveç sa parashikohet në Seksionin 7.1 më lart, palët e treta nuk kanë asnjë pretendim apo të drejtë në lidhje me kapitalin e emetuar të Bankës dhe as të drejta apo pretendime për kapitalin shtesë që do emetohet.

7.6 Autorizimet

(a) Banka ka marrë të gjitha Licencat Operative dhe Autorizimet e nevojshme që të marrë titullin e pronësisë dhe të administrojë pasuritë e saj si dhe të kryejë biznesin e saj siç kryhet tani (së bashku, "Autorizimet e Bankës"), dhe nuk ka asnjë padi, procedim ose hetime pezull, në dijeni të Shitësit, apo me shkrim lidhur me pezullimin ose heqjen e një nga Autorizimeve të Bankës.

(b) Degët Greke kanë marrë të gjitha Autorizimet e nevojshme që të zotërojnë, japin me qera si dhe të administrojnë pasuritë e tyre e të kryejnë aktivitetin ashtu siç kryhet tani, dhe nuk ka asnjë padi, procedim ose hetime pezull, në dijeni të Shitësit, apo me shkrim lidhur me pezullimin ose heqjen e një nga Autorizimeve të Degëve.

7.7 Zbatimi i Ligjit

Banka nuk ka shkelur (a) asnjë rregullore ose Ligj të zbatueshëm për Bankën ose pasuritë e saj dhe (b) asnjë nga Autorizimet e Bankës. Banka nuk ka marrë njoftim me shkrim nga asnjë Autoritet për shkelje ligjore.

7.8 Deklaratat Financiare

Bashkangjitur si Shtojca 7.8 janë kopjet e Deklaratave Financiare të Bankës. Deklaratat Financiare janë në përputhje me Ligjin e zbatueshëm dhe rregulloret (përfshirë rregulloret bankare) si dhe me SSHK, që zbatohen nga Banka (në vijim "Parimet e Kontabilitetit"). Që nga data kur janë lëshuar Deklaratat Financiare, këto pasqyrojnë saktë, në të gjitha aspektet, pozitën financiare të Bankës, rezultatet e operacioneve të saj, ndryshimet e pjesëmarrjes aksionare dhe në para të aksionerëve, dhe nuk ka detyrime të papasqyruara në Deklaratat Financiare për t'u paraqitur sipas Parimeve të Kontabilitetit. Vlera e letrave me vlerë sic përshkruhet në kapitullin "Investime të maturueshme" e që pasqyrohet në Deklaratat Financiare, në rast se dhe kur është e ndryshme nga vlera e tregut për të njëjtat letra me vlerë, do garantohet nga Shitësi në përputhje me Seksionin VII të Marrëveshjes së Aksionerëve.

7.9 Punojësit

7.9.1 Punojësit e Bankës së Shqipërisë, që nga data këtu, janë renditur në Shtojcën 7.9.1.

7.9.2 Banka është në përputhje me Ligjin e punës dhe praktikat e punësimit, afatet dhe kushtet e punësimit, përfshirë por pa u kufizuar në, dispozitat lidhur me pagat, bonuset, orët e punës dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, dhe rregullat për sigurinë në punë.

7.9.3 Punojësit e Degëve në Greqi, po në këtë datë, janë renditen në Shtojcën 7.9.3.

7.9.4 Degët Greke janë në përputhje me Ligjet e punës dhe praktikat e punësimit, afatet dhe kushtet e punësimit, përfshirë por pa u kufizuar në,

dispozitat lidhur me pagat, bonuset, orët e punës dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, dhe rregullat për sigurinë në punë.

7.10 Pasuritë e Paluajtshme dhe asetet

7.10.1 Të gjitha Pasuritë e Paluajtshme në pronësi të Bankës renditën në Shtojcën 7.10.1 (në vijim "Pasuritë e Paluajtshme"). Pasuritë e Paluajtshme janë të lira dhe të pastra nga çdo Barrë.

7.10.2 Pasuritë e Paluajtshme janë në përputhje me Ligjin dhe mbahen në kushte të mira për përdorimin e tyre. Banka ka titull pronësie të rregullt, të vlefshëm, efektiv dhe të padiskutueshëm mbi Pasuritë e Paluajtshme.

7.10.3 Banka zotëron titull pronësie të rregullt, të vlefshëm, efektiv dhe të padiskutueshëm mbi të gjitha asetet e saj. Ky titull është i lirë dhe i pastër nga çdo Barrë, përveç Barrëve që parashikon Ligji.

7.11 Taksat

(a) Gjithë taksat e rimbursueshme dhe raportet (në vijim si "Rimbursim Taksash") lidhur me Taksat që Banka duhej të depozitonte, sipas kërkesës, në ose para Datës së Mbylljes, janë depozituar rregullisht dhe në kohë. Cdo Rimbursim Taksash është i rregullt, i saktë dhe i plotë. Të gjitha taksat që përfshihen në Rimbursim Takse janë paguar në kohë në mënyrë të plotë dhe zërat e duhura për këto Taksa janë parashikuar në Deklaratat Financiare. Të gjitha kërkesat për Taksën në burim për dhe lidhur me Bankën janë përmbushur tërësisht në të gjitha kuptimet.

7.12 Taksat dhe detyrimet për Sigurimet Shoqërore të Degëve Greke.

(a) Të gjitha taksat e rimbursueshme dhe certifikatat për dhe në lidhje me Taksat që Degët në Greqi duhet të depozitonin në dhe para Datës së Mbylljes janë depozituar rregullisht dhe në kohë. Cdo Rimbursim Taksash dhe cdo certifikatë janë të rregullt, të saktë dhe të plotë. Të gjitha taksat që përfshihen në cdo rimbursim takse dhe certifikatë janë paguar në kohë e në mënyrë të plotë dhe zërat e duhura për këto Taksa janë parashikuar në Deklaratat Financiare. Të gjitha kërkesat për Taksën në burim për dhe lidhur me Bankën janë përmbushur tërësisht në të gjitha kuptimet.

(b) Të gjitha taksat e rimbursueshme dhe certifikatat për dhe në lidhje me detyrimet përkundrejt zyrës së Sigurimeve Shoqërore Greke që sipas kërkesave, duhej të depozitoheshin në ose para Datës së Mbylljes nga Degët Greke, janë depozituar rregullisht dhe në kohë. Cdo Rimbursim Taksash dhe certifikatë është e rregullt, e saktë dhe e plotë. Të gjitha detyrimet përkundrejt Sigurimeve Shoqërore Greke që tregohen në taksat e rimbursueshme dhe certifikatat janë paguar në kohë ose zërat e duhur për këto detyrime janë parashikuar në Deklaratat Financiare.

7.13 Marrëveshjet

Të gjitha marrëveshjet që ka lidhur Banka janë të vlefshme, efektive dhe plotësisht të zbatueshme ndërmjet palëve këtu dhe janë lidhur në përputhje me parimet e administrimit të zakonshëm dhe të saktë si dhe në përputhje me afatet e kushtet e standarteve të tregut për palët që nuk lidhen me to.

7.14 Kreditë dhe llogaritë huadhënie afatshkurtër

7.14.1 Pavarësisht nga sa përcaktohet në Seksionin 7.8 më sipër, kreditë dhe llogaritë e huadhënies afatshkurtër të Bankës që rezultojnë në Deklaratat Financiare janë:

- (a) plotësisht të vlefshme dhe të mirëqena, pa asnjë kufizim statutor, konfiskim, heqje dorë ose shlyerje të cfarëdo lloji në lidhje me to, përveç sa parashikohet për to në dispozitat për llogaritë huadhënie afatshkurtër të Deklaratave Financiare apo në kufijtë e lejueshëm nga pagesat përkatëse.
- (b) të dokumentuara saktë nga urdhëra të vlefshëm dhe në fuqi, kontrata ose marrëveshje.

7.14.2 Kreditë dhe llogaritë huadhënie afatshkurtër të Bankës që pasqyrohen në Deklaratat Financiare janë vlerësuar në përputhje me Ligjin nr. 8365, datë 2 korrik, 1998, me parimet e kontabilitetit që përcaktohen nga Autoriteti bankar Shqiptar si dhe me dispozitat për këto kredi e llogaritë huadhënie afatshkurtër që janë në përputhje me këtë vlerësim.


7.15 Mosmarrëveshjet

Përveç nga sa përcaktohet në Shtojcën 7.15, Banka nuk është subjekt i asnjë procedure gjyqësore, arbitrazhi, administrative ose procedime të tjera nga, përkundrejt, ose në lidhje me të apo pasuritë e saj, dhe as, sa në Dijeni të Shitësit, i ndonjë konflikti me shkrim. Banka nuk ka marrë asnjë njoftim në lidhje me ndonjë hetim zyrtar apo qeveritar që ka të bëjë me të dhe asnjë investigim apo hetim nuk është në proces apo pezull.

7.16 Struktura dhe vendimet e Bordit Drejtues

Numri i anëtarëve të Bordit Drejtues të Bankës aktualisht në detyrë është 8 (tetë). Anëtarët aktualisht në detyrë dhe të mëparshëm të Bordit Drejtues të Bankës, janë dhe kanë patur plotësisht të drejtë, që të kryejnë aktivitetet dhe detyrat si dhe të marrin vendimet që lidhen me funksionin e tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit Shqiptar.

7.17 Polica e Sigurimit



Politikat e policës së sigurimit nëpërmjet të cilave Banka dhe/ose Degët në Greqi sigurohen ndaj riskut të mospagimit të kredive janë të vlefshme, efektive dhe të pagueshme sipas dispozitave përkatëse të ligjit që rregullojnë këto politika.

7.18 Dispozitat që qëndrojnë në fuqi

Përvec deklaratave dhe garancive në Seksionin 7.9, 7.11 dhe 7.12 që do mbeten në fuqi dhe pas Datës së Mbylljes deri në mbarimin e afatit të periudhave kufizuese statutores që zbatohet për veprime nga ku lind detyrimi për dëmshpërblim sipas Seksionit IX më poshtë, deklaratat dhe garancitë e Shitësit sipas Seksioneve VII.A dhe VII.B do mbeten në fuqi dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas Datës së Mbylljes. Pas kësaj periudhe, nuk mund të ngrihet asnjë pretendim për shkelje të kontratës ose sipërmarrjeve apo pretendim për dëmshpërblim.

7.19 Zgjidhja si shkak i Njoftimit të Pretendimit

Nëse, para mbarimit të afatit të zbatueshën për dispozitat që mbeten në fuqi sic parashikohet në Seksionin 7.18 më sipër, Njoftimi për Pretendim (sic përkufizohet më poshtë) jepet në mirëbesim nga Blerësi sipas Seksionit 11.1, lidhur me shkeljen e deklaratave dhe garancive të Shitësit sipas Seksioneve VII.A dhe VII.B, si rrjedhojë deklaratat e garancitë, objekt i Njoftimit për Pretendim si më lart, do vazhdojnë të mbeten në fuqi vetëm për qëllimin e këtij Njoftimi për Pretendim dhe përtej afateve që përcaktohen në Seksionin 7.18 më lart deri në mbarimin e afatit të Deklaratës përkatëse për Dëmshpërblim (sic përcaktohet më poshtë) në përputhje me Seksionin XI ose Seksionin XII të kësaj Marrëveshjeje, dhe sipas rastit.

7.20 Due Diligence:; Vlerësimi i lirë

Blerësi njihet dhe deklaron se ai ka hartuar Due Diligence kërkimore për Bankën në lidhje me çështjet financiare, ekonomike, taksat, çështjet ligjore dhe të tjera. Blerësi, më tej njihet dhe pranon se asnjë zotim, deklaratë apo garanci (e shprehur apo e pashprehur) për korrektesinë, cilësinë, saktësinë, rëndësinë, tërësinë apo mjaftueshmërinë, për qëllimet e Blerësit, të informacionit dhe dokumenteve, që i janë siguruar apo vënë në dispozicion të Blerësit apo këshilltarëve të tij, gjatë hetimit të tyre, është kryer apo u krye nga Shitësi, Banka apo punojësit, drejtorët, nëpunësit, menaxherët, agjentët apo këshilltarët e saj përkatës. Kuptohet që një deklaratë e tillë e Blerësit, nuk kufizon deklaratat dhe garancitë e Shitësit për Blerësin, në këtë Marrëveshjeje.

SEKSIONI VIII – DEKLARATA DHE GARANCI TË BLERËSIT

Blerësi lëshon vetëm për Shitësin deklarata dhe garanci në Seksionin VIII. Shitësi njihet dhe pranon se Blerësi nuk do lëshojë deklaratë apo garanci tjetër, qoftë e shprehur apo e pa shprehur, në ndonjë Seksion ose klauzolë tjetër të kësaj

Marrëveshje ose kudo tjetër dhe që deklaratat dhe garancitë e dhëna Shitësit në këtë marrëveshje zëvendësojnë çdo deklaratë ose garanci tjetër shtesë ose garanci të çdo lloji që parashikohen nga Ligji i zbatueshëm. Deklaratat dhe garancitë që lëshohen nga Blerësi si më poshtë janë të vërteta dhe të sakta në Datën e Ekzekutimit dhe në Datën e Mbylljes.

8.1 Fuqia Ligjore; Autorizimi; Zbatimi

Blerësi është një shoqëri themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas Ligjeve të Italisë dhe ka fuqi dhe autoritet të plotë për të: (i) ekzekutuar dhe zbatuar këtë Marrëveshje; (ii) përmbushur detyrimet e saj si më poshtë (përfshirë, pa kufizime, pagesën e Cmimit) dhe (iii) të përfundojë transaksionet që përcaktohen më poshtë. Blerësi nuk është deklaruar, dhe nuk është, i paaftë të paguajë dhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit ose të tjera të ngjashme me to. Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje dhe i çdo marrëveshje tjetër për tu zbatuar nën ose në lidhje me, dhe aty ku është e zbatueshme, kryerja e transaksioneve që parashikohen këtu janë autorizuar rregullisht dhe janë miratuar nga organet kompetente të Blerësit. Kjo Marrëveshje përbën një detyrim të vlefshëm ekzekutiv për Blerësin, të ekzekutueshëm ndaj tij në përputhje me afatet që përcaktohen këtu, subjekt i dispozitave urdhëruese sipas Ligjit të zbatueshëm. Përveç kësaj, Blerësi deklaron dhe garanton se nëse realizohet shkëmbimi që parashikohet për Blerësin në Banca Intesa S.p.A, kjo e fundit do trashëgojë të gjitha cilësitë kontraktuale dhe ligjore të Blerësit, përfshirë këtu dhe të gjitha detyrimet, të drejtat dhe detyrat që parashikohen e rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

8.2 Mjetet Financiare

Blerësi zotëron mjetet financiare e nevojshme për përmbushjen e çdo dhe të gjitha detyrimeve financiare si më poshtë, dhe sidomos për pagesën e Cmimit dhe të çdo Takse të detyrueshme në lidhje me transaksionet që parashikohen këtu.

8.3 Dispozitat që mbeten në fuqi

Deklaratat dhe garancitë e Blerësit sipas këtij Seksioni VIII do mbeten në fuqi dhe për 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas Datës së Mbylljes dhe nuk mund të jenë shkak për pretendime për shkelje të kontratës ose pretendim për dëmshpërblim pas periudhës së lartpërmendur.

SEKSIONI IX – DËMSHPËRBLIMI NGA ANA E SHITËSIT

9.1 Dëmshpërblimi nga Shitësi

Sipas Seksioneve 7.18 dhe 9.2, nga dhe pas Datës së Mbylljes, Shitësi bie dakord të dëmshpërblejë Blerësin nga dhe për 80% (tetëdhjetë për qind) të:

- (i) cdo humbjeje reale, dëm, kosto ose shpenzim, me përjashtim të humbjeve mbi fitimet ose humbjeve a dëmeve indirekt ose si rrjedhojë ("Humbja"), që pësohen ose shkaktohen nga vetë Blerësi ose Banka si pasojë e shkeljes, jo vërtetësisë ose e pasaktësisë të një prej deklaratave ose garancive që parashikohen në Seksionet VII.A dhe VII.B, e që lindin dhe varen nga akte, fakte, ngjarje ose rrethana që janë krijuar apo që kanë ndodhur në ose para Datës së Mbylljes, edhe pse Humbja rezulton pas një date të tillë; ose
- (ii) cdo Humbje që pësohet apo ndodh në mënyrë direkte nga Blerësi dhe/ose Banka si rezultat i ndonjë shkelje të detyrimeve të Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

9.2 Përjashtime dhe Kufizime të përgjegjësisë të Blerësit

Pavarësisht nëse parashikohet ndryshe nga Ligji i zbatueshëm, Blerësi pranon dhe bie dakord si më poshtë:

9.2.1 Shitësi nuk do jetë përgjegjës ndaj Blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Blerësi nuk ka të drejtë për asnjë dëmshpërblim për sa më poshtë:

- (i) nëse shuma që duhet të paguhet për cdo akt, nga i cili lind një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, të mos kalojë vlerën prej 20,000 Euro (njëzet mijë) (në vijim si "Shuma e vetme e Zbritshme."); dhe
- (ii) vetëm nëse totali i shumave të pagueshme sipas Seksionit 9.1 (me përjashtim të shumave jo të pagueshme sipas paragrafit (i) të mësipërm) kalon shumën prej 300,000 Euro (treqind mijë) (në vijim si "**Totali i Zbritshëm**"), e me kusht që, nëse kalohet ky kufi, Blerësi ka të drejtë të pretendojë vetëm për tepricat.

9.2.2 Për më tepër për sa parashikohet në Seksionin 9.2.1 më sipër, totali maksimal i përgjegjësisë së Shitësit në këtë Marrëveshjeje nuk do të tejkalojë 100% (njëqind për qind) të Cmimit që Shitësi do të marrë në bazë të Seksionit III të mësipërm.

9.2.3 Në rastin kur dhe deri në masën që Humbja, për të cilën kërkohet dëmshpërblim ndaj Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje, është e zbritshme nga Blerësi ose Banka për qëllime tatimore ose përcakton humbje tatimore të cdo viti tatimor, si rrjedhojë e kësaj, në këtë rast dhe në këto kufij, shuma e cdo Humbjeje e dëmshpërblyeshme nga Shitësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të zbritet me një përqindje të barabartë me përqindjen tatimore përkatëse të aplikueshme ndaj të ardhurave të Blerësit ose të Bankës.

9.2.4 Pa çenuar sa parashikohet në Seksionet 9.2.2 dhe 9.2.3 si më sipër, shuma për të gjitha dëmshpërblimet e pagueshme nga Shitësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të ulët më tej, si shkak i:

- (i) shumës së sigurimive shoqërore ose pagesave të ngjashme që Blerësi ose Banka do të marrin në lidhje me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim;
- (ii) shumës së dëmshpërblimit që Blerësi ose që Banka do të marrë nga palët e treta në lidhje me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim; dhe

- (iii) shumës së cdo rezerve ose fondi disponibël në Deklaratat Financiare për mbulimin e shkakut të dëmshpërblimit.

9.2.5 Kur llogaritja e taksave është rezultat i ndryshimit të barrës tatimore nga një vit fiskal në tjetrin, dëmshpërblimi që lidhet me të, do kufizohet në rjetin aktual dhe në koston përfundimtare në para të Blerësit.

SECTION X – DËMSPËRBLIMI NGA BLERËSI

10.1 Dëmshpërblimi nga Blerësi

Sipas Seksioneve 8.3 dhe 10.2, nga dhe pas Datës së Mbylljes, Blerësi bie dakort të dëmshpërblejë Shitësin nga dhe kundrejt cdo Humbjeje që Shitësi ka pësuar ose është shkaktuar, si rezultat i:

- (i) cdo shkelje, jo vërtetësie ose pasaktësie në deklaratat dhe garancitë e dhëna nga Blerësi në bazë të Seksionit VIII më sipër; ose
- (ii) mospërmbushjes të detyrimeve të Blerësit në këtë Marrëveshje.

10.2 Përjashtime dhe Kufizime të përgjegjësisë të Blerësit

Përvec sa parashikohet ndryshe në Ligjin e aplikueshëm, Shitësi njih dhe bie dakort si më poshtë:

10.2.1 Në rastin kur dhe deri në masën që Humbja, për të cilën kërkohet dëmshpërblim ndaj Blerësit sipas kësaj Marrëveshje, do zbritet nga Shitësi për qëllime tatimore ose përcakton humbjet tatimore të vitit tatimor, si rrjedhojë e kësaj, në këtë rast dhe në këto kufij, shuma e cdo Humbjeje që do t'i dëmshpërblehet Shitësit nga Blerësi sipas kësaj Marrëveshje do zbritet me një përqindje të barabartë me përqindjen tatimore përkatëse të aplikueshme ndaj të ardhurave të Shitësit.


10.2.2 Pa cënuar sa parashikohet në Seksionin 10.2.1 të sipërmendur, shuma për të gjitha dëmshpërblimet e pagueshme nga Blerësi tek Shitësi sipas Seksionin 10.1 do ulet si shkak i:

- (i) shumës së sigurimeve shoqërore ose pagesave të ngjashme që Shitësi merr lidhur me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim;
- (ii) shumës së dëmshpërblimit që Shitësi merr nga palët e treta në lidhje me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim; dhe

SEKSIONI XI – PROCEDURA E DËMSPËRBLIMIT

11.1 Pretendimi për Dëmshpërblim

Në rast se një nga Palët (në vijim si “Pala e Dëmshpërblyer”) vihet në dijeni për ndonjë pretendim, procedim ose tjetër (“Pretendimi për Dëmshpërblim”) në



lidhje me të cilën Pala tjetër (kjo Palë në vijim si “Pala e Dëmshpërblyer”) ka rënë dakort të dëmshpërblejë Palën e Dëmshpërblyer sipas kësaj Marrëveshje, kjo e fundit do të njoftojë me shkrim (“Njoftimi i Ankimit”) Palën Dëmshpërblyese brenda 20 (njëzet) ditëve Punë nga momenti që bëhet me dije për Pretendimin për Dëmshpërblim. Pas mbarimit të këtij afati, Pretendimi për Dëmshpërblim do të konsiderohet i parashkruar. Në rastin kur afati i fundit për të apeluar, për të kundërshtuar ose për të kryer një veprim tjetër lidhur me Pretendimin për Dëmshpërblim është më pak se 20 (njëzetë) Ditë Punë, Pala e Dëmshpërblyer do t’i komunikojë Njoftimin e Pretendimit Palës Dëmshpërblyese brenda këtij afati të shkurtër sipas rrethanave më të përshtatshme për të bërë të mundur depozitimin e apelimit, kundërshtimit apo të një veprimi të tillë. Në kuptimin e kësaj dispozite, njoftimi i Bankës do quhet dhe njoftim i Blerësit. Njoftimi i Pretendimit do specifikojë nëse Pretendimi për Dëmshpërblim është rezultat i pretendimeve të palëve të treta kundrejt Palës së Dëmshpërblyer (“Pretendim i Palëve të Treta”) ose ndryshe (“Pretendim i Drejtpërdrejtë”), si dhe do specifikojë më tej bazën e fakteve të detajuara në mënyrë të arsyeshme të Pretendimit për Dëmshpërblim (sa lejon informacioni që disponon) dhe shumën e Pretendimit për Dëmshpërblim, nëse dihet, si edhe deklaratat specifike, garancitë ose dispozitat e kësaj Marrëveshje për të cilat Blerësi pretendon se janë shkelur.

11.2 Pretendimet e Drejtpërdrejta

Në lidhje me Pretendimet e Drejtpërdrejta, Pala Dëmshpërblyese pas marrjes së Njoftimit për Pretendim nga Pala e Dëmshpërblyer, do ketë 30 (tridhjetë) Ditë Punë kohë për të hetuar për Pretendimin për Dëmshpërblim nëse e quan të nevojshëm ose dëshiron kështu; lidhur me këtë, Pala e Dëmshpërblyer vë në dispozicion të Palës Dëmshpërblyese regjistrat, personelin dhe këshilltarët e saj dhe të Bankës për të mundësuar që Pala Dëmshpërblyese të kryejë një hetim të plotë. Përveç rastit kur Pala e Dëmshpërblyer dhe Pala Dëmshpërblyese bien dakort, në ose para afatit prej 30 (tridhjetë) Ditë Punë, mbi vlefshmërinë dhe shumën e Pretendimit për Dëmshpërblim, e si rrjedhojë e kësaj Pala Dëmshpërblyese do t’i paguajë menjëherë Palës së Dëmshpërblyer shumën e plotë për të cilën është rënë dakort të Pretendimit për Dëmshpërblim, Pretendimi i Drejtpërdrejtë përkatës do t’i referohet arbitrazhit detyrues për palët siç parashikohet në Seksionin XII.

11.3 Pretendimet e Palëve të Treta

Lidhur me Pretendimet e Palëve të Treta, pavarësisht nëse Pala Dëmshpërblyese ka rënë dakord të dëmshpërblejë Pretendimin për Dëmshpërblim, kjo ka të drejtë, që me shpenzimet e veta, të marrë pjesë dhe të pretendojë kontrollin e negociatave, zgjidhjes dhe mbrojtjen e pretendimit. Nëse Pala Dëmshpërblyese vendos të pretendojë për këtë kontroll, Pala e Dëmshpërblyer (i) do sigurojë dhe do mundësojë që Banka t’i sigurojë Palës Dëmshpërblyese informacionin dhe dokumentat që mund të duhen për të mbrojtur Bankën nga Pretendimet e Palëve të Treta, pa shpenzime nga Pala Dëmshpërblyese, dhe se cdo informacion e

dokumentacion i tillë do jetë konfidencial; (ii) do mundësojë që Banka të informojë rregullisht dhe në kohë Palën Dëmshpërblyese në cdo kohë për komunikimet, njoftimet apo informacion tjetër që ajo merr lidhur me çështjet subjekt të këtij pretendimi; (iii) do veprojë në kohë, në përputhje me dhe do mundësojë që Banka të veprojë në kohë në përputhje me udhëzimet e arsyeshme të Shitësit në veprimet për çështjet ligjore dhe/ose negociatat për zgjidhjen e tyre dhe/ose veprimet e tjera që lidhen me to. Pala e Dëmshpërblyer ka të drejtë të marrë pjesë në negociata, në zgjidhjen e tyre apo në mbrojtjen e Pretendimeve të Palëve të Treta si dhe të punësojë një avokat, me shpenzimet e veta, që të veprojë për llogari të saj. Nëse Pala Dëmshpërblyese, që ka vendosur të pretendojë këtë kontroll, nuk mbron brenda një kohe të arsyeshme Pretendimin e Palëve të Treta, Pala e Dëmshpërblyer do të ketë të drejtë të pretendojë për këtë kontroll, dhe Pala Dëmshpërblyese është e detyruar të pranojë rezultatet lidhur me Pretendimin e Palëve të Treta që nxjerr Pala e Dëmshpërblyer. Në rast se Pala Dëmshpërblyese vendos që të mos kryejë këtë kontroll, si rrjedhojë Pala e Dëmshpërblyer duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën Dëmshpërblyese lidhur me avokatin që kjo apo Banka do punësojë, sipas rastit, për të mbrojtur Pretendimin e Palëve të Treta dhe se Pala e Dëmshpërblyer duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim, në lidhje me sa më lart, të Palës Dëmshpërblyese e cila nuk do ta refuzojë pa shkak. Pala e Dëmshpërblyer do mbrojë në mënyrën e duhur dhe me përpikmëri si dhe do mundësojë që Banka të veprojë në të njëjtën mënyrë për të mbrojtur cdo Pretendim të Palëve të Treta dhe do njoftojë Palën Dëmshpërblyese menjëherë e për të gjitha nismat dhe veprimet që lidhen me sa më lart. Pala e Dëmshpërblyer nuk do pranojë asnjë përgjegjësi, dhe nuk do pranojë asnjë zgjidhje lidhur me Pretendimin e Palëve të Treta pa miratimin paraprak me shkrim të Palës Dëmshpërblyese, me kuptimin që (i) cdo zgjidhje që propozohet duhet të sigurojë që pala e tretë që ngre Pretendimin përkatës së Palës së Tretë nuk do ngrejë asnjë pretendim në të ardhmen përveç kësaj dhe se zgjidhja e propozuar si më lart do jetë përfundimtare dhe e detyrueshme për palët e treta, (ii) miratimi i Palës së Dëmshpërblyese nuk do refuzohet pa shkak, dhe (iii) pranimi i zgjidhjes nga Pala e Dëmshpërblyer të Pretendimit të Palëve të Treta pa miratimin paraprak të Palës Dëmshpërblyese do quhet nga kjo e fundit si ç'liberim nga detyrimi i saj për dëmshpërblim të Palës së Dëmshpërblyer në lidhje me këtë Pretendim, përveç rastit (a) kur Pala Dëmshpërblyese nuk shpreh mendimin e saj, lidhur me zgjidhjen e propozuar, brenda 10 Ditë Pune nga marrja e kërkesës së Palës së Dëmshpërblyer ose (b) zgjidhja sjell si pasojë uljen e Humbjeve.

11.4. Zbutja e Humbjeve

- Pala e Dëmshpërblyer do përpiqet maksimalisht (përfshirë këtu kundërshtimin e pretendimeve përkatëse) për uljen e humbjeve dhe do mundësojë që Banka të veprojë në të njëjtën mënyrë për cdo Humbje që do dëmshpërblehet sipas Seksionit XI, para dhe pas Njoftimit për Pretendim, si dhe do njoftojë në kohë dhe për të gjitha Shitësin, në lidhje me këto nisma apo veprime. Është e kuptueshme dhe Palët kanë rënë dakord që në rast se Blerësi nuk përmbush dispozitat e Seksionit 11.4 Shitësi lirohet nga detyrimi i tij që të dëmshpërblejë Blerësin për

Pretendimin përkatës për Dëmshpërblim në masën që mospërmbushja cënon Shitësin.

11.5 Pagesa

Pagesa e gjithë shumave që Pala Dëmshpërbllyese ka si detyrim sipas Seksionit XI do kryhet në përputhje me Seksionin 13.7 menjëherë pas përcaktimit të shumës që do dëmshpërblehet, por jo më vonë se 10 (dhjetë) Ditë Pune/pas datës së përcaktimit. Në rastin e Pretendimit të Palëve të Treta (përfshirë këtu dhe pretendimin nga një autoritet publik), cdo dëmshpërblim që do kryhet nga Pala Dëmshpërbllyese tek Pala e Dëmshpërbllyer, si këtu më poshtë, bëhet i detyrueshëm dhe i pagueshëm vetëm kur pretendimi përkatës bëhet përfundimtar dhe nuk është subjekt i asnjë apelimi në të ardhmen apo të mëparshëm, dhe në rastin e një vendimi gjyqësor ekzekutiv apo kur cdo vendim tjetër administrative marr fuqi ligjore dhe detyron Palën e Dëmshpërbllyer të kryejë pagesën (me kusht që, nëse pretendimi është subjekt apelimi apo kundërshtimi në të ardhmen, dhe këto ulin apo c'lirojnë nga përgjegjësia Bankën apo Blerësin, cdo shumë tepri që fillimisht është dëmshpërbllyer nga Shitësi do t'i kthehet menjëherë këtij).

SEKSIONI XII – ARBITRAZH I DHE VENDI I ARBITRAZHIT

Cdo konflikt, mosmarrëveshje apo pretendim që lind apo lidhet me këtë Marrëveshje, apo cdo shkelje, përfundim apo pavlefshmëri e kësaj, do zgjidhet me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL në fuqi. Do caktohen tre arbitra, dy prej të cilëve do caktohen nga secila prej Palëve dhe arbitri i tretë, i cili do veprojë në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues të arbitrazhit, do caktohet nga arbitrat e cdo Pale, dhe në rast se Palët nuk bien dakord brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga caktimi i dy arbitrave, arbitri i tretë do caktohet nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Londrës. Selia dhe vendi i arbitrazhit është Londër, Angli dhe gjuha angleze do përdoret në të gjitha çështjet gjyqësore. Palët heqin dorë nga cdo e drejtë sipas Aktit të Arbitrazhit 1996 apo nga apelimi i vendimit të arbitrazhit, apo nga kërkesa për të zgjidhur çështjen nga gjykatat e Italisë ose Shqipërisë. Gjykata e Arbitrazhit nuk është e autorizuar që të marrë apo të sigurojë, dhe Palët bien dakord që nuk do kërkojnë nga asnjë autoritet gjyqësor, masa të përkohshme për mbrojtjeje apo masa lehtësuese para gjykimit përkundrejt palës tjetër, pavarësisht nga dispozitat e Rregullave të Arbitrazhit UNCITRAL.

SEKSIONI XIII – TË NDRYSHME

13.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera që do kryhen apo do jepen në përputhje me sa parashikohet këtu, do jenë me shkrim dhe në Anglisht, do quhen se i janë komunikuar Palëve me marrjen e njoftimit të dorëzimit në se dorazi, të postuar përkundrejt postës të regjistruar apo me vërtetim (postë e


parapaguar me kthim përgjigje) në adresat e mëposhtme (ose në adresat që Palët i komunikojnë njëra-tjetrës me shkrim) ose të dërguar me fax apo mënyrë elektronike në numrat e faksit apo adresat elektronike që përcaktohen më poshtë (konfirmimi i dërgimit të faksit dhe i hapjes së postës elektronike përbëjnë provë të vlefshme për marrjen e faksit dhe të komunikimit me postë elektronike);

- Për Blerësin
Në vëmendje të: Drejtorit të Rrjetit të Huaj
San Paolo IMI
Piazza San Carlo, 156
10121 Torino, Italy
Tel.: + 39 011 555 7892
Nr. Fax.: + 39 011 555 2141
E-mail: giuseppe.cuccurese@sanpaoloimi.com

Një kopie për:
Në vëmendje të: Drejtorit të Departamentit të Aksionarëve
San Paolo IMI
Piazza San Carlo, 156
10121 Torino, Italy
Tel.: + 39 011 555 3474
E-mail: + 39 011 555 6668
E-mail: flavio.gianetti@sanpaoloimi.com

- Për Shitësin:
Në vëmendje të: z. Jeffrey Griffin
President dhe Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptari-Amerikan të Ndërmarrjeve
Rr: "Dëshmorët e 4 Shkurtit"
Kompleksi "Green Park"
Kulla 2, Kati 12
Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 222 408
Nr. Fax.: + 355 4 271 952
E-mail: j.griffin@aaef.com

Një kopie për:
z. Michael D. Granoff
Kryetari i Fondit Shqiptari-Amerikan të Ndërmarrjeve
Care of Pomona Capital
780 Third Avenue, 44th floor
Neë York, NY 10017 - 7076
USA
Tel: 001 212 5930727



Nr. Fax.: 001 212 593 3987
E-mail: mgranoff@pomonacapital.com

dhe

Z. Roberto Casati
Cleary Gottlieb Steen & Hamilton LLP
Via San Paolo 7
20121 Milan, Italy
Tel: + 39 02 726081
Nr. Fax.: +39 02 86984440
E-mail: rcasati@cgsh.com



Secila Palë mund të ndryshojë në cdo kohë adresën e saj të shërbimit dhe njofton Palën tjetër në përputhje me këtë Seksion 13.1.

13.2 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje (bashkë me Shtojcat e saj) përbën tërësinë e Marrëveshjes për Palët dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet paraprake dhe angazhimet, me shkrim e me gojë, të Palëve, lidhur me çështjet subjekt të Marrëveshjes.

13.3 Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve

Kjo Marrëveshje dhe cdo dispozitë e saj nuk do transferohet, sipas ligjit apo ndryshe, nëse Palët nuk bien dakord me shkrim.

13.4 Ndryshimet

Kjo Marrëveshje do ndryshohet vetëm me dokument me shkrim të nënshkruar nga Palët.

13.5 Heqja dorë

Heqja dorë nga e drejta, shkelja apo mospërbushja si këtu më poshtë do quhet e vlefshme vetëm me dokument me shkrim të Palës që heq dorë, dhe kjo nuk do quhet si heqje dorë nga një shkelje apo mospërbushje, qoftë kjo e njëjtë apo e ngjashme.

13.6 Tarifat, Shpenzimet dhe Pagesa të tjera

13.6.1 Cdo dhe të gjitha Taksat, shpenzimet noteriale dhe tarifatat e tjera zyrtare e shpenzimet që do kryhen për shitjen dhe transferimin e Pjesëmarrjes do mbulohen nga Blerësi.

13.6.2 Pa çënuar dispozitat e Seksionit 13.6.1 si më lart, Blerësi dhe Shitësi do mbulojnë kostot dhe shpenzimet e tyre përkatëse lidhur me këtë Marrëveshje dhe me transaksionet që parashikohen po në këtë Marrëveshje. Shitësi do mbulojë të gjitha kostot, shpenzimet apo tarifatat e pagueshme për këshilltarët financiarë, avokatët, ekonomistët apo përfaqësuesit e tjerë që janë punësuar nga Shitësi për transaksionet që parashikohen në Marrëveshje. Blerësi do mbulojë të gjitha kostot, shpenzimet apo tarifatat e pagueshme për këshilltarët financiarë, avokatët, ekonomistët apo përfaqësuesit e tjerë të punësuar nga Blerësi në lidhje me transaksionet që parashikohen në Marrëveshje.

13.7 Kryerja e Pagesave

13.7.1 Përyecse kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, cdo dhe të gjitha pagesat që do kryhen nga njëra Palë tek Pala tjetër do kryhen si pagesa të lira, në datën e caktuar për kryerjen e tyre, e me transfertë në llogarinë bankare që Pala e cila merr pagesën i komunikon Palës paguese – së paku 5 (pesë) Ditë Pune para datës së caktuar për kryerjen e pagesës.

13.7.2 Cdo pagesë që do kryhet sipas kësaj Marrëveshjeje, është shumë neto pa asnjë zbitje, Taksën në burim apo të ndryshme, tarifatat apo shpenzimet bankare apo kosto të tjera (së bashku, "Tarifat"). Në cdo rast tarifa do zbatohet sipas Ligjit të zbatueshëm, dhe Pala që është debitor do paguajë Palës tjetër një shumë shtesë në mënyrë që pas pagimit të Tarifës Pala të marrë shumën neto që përcaktohet në këtë Marrëveshje.

13.8 Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të hartohet në shumë kopje, dhe nga secila Palë në kopje të vecanta, të cilat kur zbatohen quhen të njëjta me origjinalin e të gjitha së bashku përbëjnë një dhe Marrëveshjen e vetme.

13.9 Legjislacioni i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje dhe cdo dispozitë e saj rregullohet, interpretohet dhe është hartuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar por pa çënuar dispozitat që rregullojnë konfliktin midis ligjeve.

SAN PAOLO IMI S.P.A

FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDERRMARJEVE